**VENDIM**
**Nr. 150, datë 13.3.2018**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 431, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT, PROCEDURAVE DHE TË MASËS PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL, DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE NË ZONAT PILOT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim emërtimi "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë" zëvendësohet me "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

2. Në pikën 1, të kreut I, fjalët "... për një periudhë 6-mujore ..." zëvendësohen me "... deri më 31.12.2019 ...".

3. Në shkronjën "c", të pikës 2, të kreut II, pas emërtimit "Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM)" shtohet "/Qendra Kombëtare e Mirëritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF)".

4. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalia e dytë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet sa herë indeksohet pensioni social.".

b) Në shkronjën "c", fjalët "… kufizime të thella …" zëvendësohen me "… kufizime të rënda…".

c) Në shkronjën "ç", fjalët "… kufizime të rënda …" zëvendësohen me "… kufizime të thella…".

ç) Në shkronjën "a", të pikës 5, fjalët "… raportin vjetor mjekësor …" zëvendësohen me "… formularin vjetor mjekësor të plotësuar nga mjeku specialist …".

d) Në shkronjën "c", të pikës 10, fjalët "... pas periudhës 2-vjeçare të punësimit ..." zëvendësohen me "... pas 48 muajve të punësimit ...".

dh) Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

"13. Shërbimi i ndihmësit personal ofrohet nga individë të cilët kanë vendbanimin në Shqipëri, brenda së njëjtës bashki me personin me aftësi të kufizuara, kanë aftësi mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime dhe nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë.".

e) Në pikën 14, pas fjalëve "… përmes një kontrate …" shtohen "… ose deklarate …".

5. Në fund të pikës 2, të kreut V, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Shërbimi Social Shtetëror ngre komisionin e shqyrtimit të ankesave, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.".

6. Pika 1 e kreut VI ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) përfituesit ekzistues sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të cilët janë të verbër, invalidë pune, si edhe të verbrit të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) aplikuesit për herë të parë të moshës 0 deri në 2 vjeç, që kërkojnë të vlerësohen sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar;

c) aplikuesit për herë të parë që kërkojnë të vlerësohen sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit

të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

ç) përfituesit ekzistues sipas pikave 1 e 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

d) aplikuesit për herë të parë të moshës 0 deri në 2 vjeç, që kërkojnë të vlerësohen sipas pikave 1 e 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", të ndryshuar;

dh) aplikuesit për herë të parë që kërkojnë të vlerësohen sipas pikës 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

e) përfituesit ekzistues sipas pikës 1, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik", të ndryshuar.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**